



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.106, datë 30.10.2020

PËR
MIRATIMIN E TARIFAVE TË PAJTIMIT MUJOR PËR TRANSPORTIN QYTETAS
NË BASHKINË E DURRËSIT

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar, VKM-së nr. 85, datë 8.2.2017 “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”, Udhëzimit Nr. 3743, datë 10.07.2017 të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës “Mbi modelet dhe standartet e biletave të transportit të udhëtarëve rrugor të udhëtarëve”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.233, datë 16.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së biletave të transportit qytetas të udhëtarëve me autobus” i ndryshuar, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e tarifave të pajtimit mujor për transportin qytetas në Bashkinë e Durrësit, si më poshtë;
 - 1.1 Bileta e pajtimit mujor, për një linjë 1200 (njëmijë e dyqind) lekë, duke përfshirë dhe TVSH.

- 1.2 Bileta e pajtimit mujor, të përgjithshëm për të gjithë linjat, 1600 (njëmijë e gjashtëqind) lekë, duke përfshirë dhe TVSH.
- 1.3 Bileta e pajtimit mujor për studentët 600 (gjashtëqindë) lekë, duke përfshirë dhe TVSH.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Durrës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.10.2020

BASHKIA DURRËS
Dt: 04/11/20 Nr. 129254 PROT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 992/prot.
15

Durrës, më 04/11/2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.106 datë 30.10.2020 “Për miratimin e tarifave të pajtimit mujor për transportin qytetas në bashkinë e Durrësit”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

